

# STATUT I SHOQERISE "Mangalemi Sofa" sh.p.k

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte Ligji Nr 9901, dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

- "Statuti" eshte statuti i shoqerise, i cili do te interpretohet se perfshin dhe ose inkorporon aktin e themelimit te shoqerise, organizimin dhe funksionimin e te ciles rregullon.

## Kreu I

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

### Neni 1

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me date 23.01.2024, ortakû themelon nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin "**Mangalemi Sofa**" sh.p.k.

Ortaku i shoqerise eshte:

**Z.Ermir BEGO**, lindur me 17.02.1987 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar nepermjet kartes se identitetit nr. 036095936 me nr.personal I70217042M.

### Neni 2

#### Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Sherbime konsulence per individe, korporata dhe agjensite qeveritare financiare, sherbime konsulence te cilat do te perfshijne por pa u limituar tek investimet, financa, burimet njerezore, siguria etj. Menaxhim te burimeve njerezore dhe llogjistikes. Shoqeria do te veproje si shoqeri outsourcing duke i ofruar kete lloj sherbimi cdo pale te trete te interesuar ne perfitimn e sherbimeve te burimeve njerezore, duke perfshire por pa u kufizuar ne personel te specializuar, ndermjetesim per punesim, mbajtjen e dosjeve te personelit dhe ndjekjen e praktikave te punesimit, survejimin dhe mbikqyrjen e veprimtarise se punemarresve me mjete elektronike apo permes rregulloreve dhe raportimit, hartimin e rregulloreve te punes dhe politikave te shoqerise per kordinimin e veprimtarise, etj.

Prodhim produktesh metalike dhe mobiljesh . etj. Tregti – Import – Eksport: Tregtimi, importimi, eksportimi, i te gjithe mallrave, te cdo makinerie dhe pajisje industriale, tregtimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, tregtimi i tokes, tregtimi i materiale gjysem teprodhurara dhe plotesisht te prodhuara, import-eksporti dhe tregtimi i produkteve industriale, materialeve te ndertimit, medias, te lendeve te para dhe atyre akomoduese, te makinerive, te cdo lloj metali, materiali drusor, te artikujvete paperpunuar dhe te prodhuar per procesin e prodhimit;

Implementimi dhe menaxhimi i projektit gjenerues te energjise elektrike, fotovoltaike dhe veprave ndihmese. Ndertimi i objekteve hidroteknike, fotovoltaike etj te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme.

Shitja e energjise elektrike klineteve dhe blerja e energjise elektrike nga operator te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit.

Transmetimi i energjise elektrike ne sistemet e tensionit te larte funksioni i cili perfshine transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.

Perdorimin e sistemeve te linjave.strukturave mbeshtetese dhe pajisjeve transformueseper transmetimin e energjise elektrike.

Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemin shperndares te tensionit te mesem e te ulet, duke patur parasyshe shperndarjen deri te konsumatori i fundit Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe ose pjesmrrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar.

Bar – Restorant, Hoteleri, Shoqeria mund te hyj ne tregje te ndryshem te zoteroj pasuri te luajtshem ose te pa luajtshem si dhe te zoteroj kompani te tjera.

Ndertim objektesh, ura, prita, ujesjellesa, kanalizime, punime mbrojtje etj. Ndertime civile dhe ekonomike. Rikonstruksion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash. Prodhim guresh dekorativ dhe inerte. Pastrim dhe gjelberim i hapësirave publike. Rehabilitim I objekteve pas shfrytezimit. Instalime elektrike dhe hidraulike. Ndertim dhe mirembajtje rruge dhe kanalizime. Materiale ndertimi, punime ndertimi, hoteleri, turizem. Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulmeve. Punime dhe sherbime te tjera te specializuara ne ndertim. Suvatime dhe montime dyer, dritare, shkalle etj. si dhe kryerja e aktiviteteve te tjera te ngjashme me to. Punime dheu, sistemim tarracash te terreneve. Prodhim i elementeve te paranderur dhe armocementit. Tregti pajisjesh te ndryshme, materiale ndertimi dhe mallra te import-eksport me shumice dhe pakice. Cdo aktivitete tjeter qe lidhet ne menyre direkte apo indirekte dhe qe u sherben aktiviteteve te siper permendura. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter I cili nuk eshte i ndaluar nga legjislacioni ne fuqi.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e papercaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia, kontakti**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: **Lagja 30 Vjetori 24/45 Z.K 8502 , Berat , Shqiperi.**

Mail: [ermirbego@gmail.com](mailto:ermirbego@gmail.com)

Tel:0696007774

Emri Tregtar: Mangalemi Sofa

### **Kreu II**

#### **Kapitali**

### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (njqind) Leke.

Kapitali i shoqerise eshte i perbere nga 1 (nje) kuote, e cila ka nje vlere nominale prej 100 (njqind) Leke.

Kjo kuote zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise Z.Ermir Bego.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kopetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, eila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## Neni 7

### Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parasgikuar ne ligj;

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohen ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

## Kreu III

### Organet Vendim Marrese dhe Drejtuese

## Neni 8

### Organet Vendim Marrese

Asambleja e Ortakeve eshte i vetmi organ vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte i vetmi organ vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- a) Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te licensuar;
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne pikat "c" dhe "d" te mesiperme;

- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare të vjetore dhe raportet e ecures se veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare të vjetore dhe raporteve të ecures se veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- m) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

Ortaku mund të përfaqesohet në asamble të përgjithshme me anë të një autorizimi, nga një ortak tjetër ose një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamble të përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamble se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamble se Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me një njoftim nepermjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe të dërgohet ortakeve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamble se.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni , ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsise.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për cështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaket që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo rnjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**



### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12**

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku te cilin perfaqeson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

1.Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripерteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.


2.Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

3. Personat e meposhtem do te caktohet administrator per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte ripерteritjeje:

Z.Emri BEGO, lindur me 17.02.1987 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar nepermjet kartes se identitetit nr. 036095936 me nr.personal 170217042M.

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratoreve**



Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullit te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vepante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te itherasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emerion me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rasis pasojat perkatese.

**Kreu IV**  
**Viti financiar-ekspertet**

**Neni 16**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**

**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar- vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

**Kreu V**

**Prishja -riorganizimi i shoqerise**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
2. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
4. të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
5. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm;

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm të rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm të shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asambleesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesës padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 20**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", "Kodit Civil" dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarreveshjet**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESITË TË KUFIZUAR**

**Z.Ermir BEGO**

ERMIR BEGO

